



20 qershor 2013

Kryetar:
Ëjllo Berishaj

Nënkryetar:
Anton Sinishtaj

Arkëtar:
Gjon Ivezaj

Sekretar:
Kolë Cacaj

Anëtarë të kryesisë:
Lekë Gjollaj

Martin Junçaj

Daniel Ivezaj

Leonard Berishaj

Pjeter Berishaj

Luigj Camaj

Halil Nikaj

Gjon Dedvukaj

Zef Lulgjuraj

Mustafë Hakramaj

Gjergj Junçaj

Lulash Junçaj

Nikollë Junçaj

Anton Ulaj

Shaqir Gjokaj

I nderuar Aplikant!

Fondi Humanitar "Malësia" në mbledhjen e radhës të mbajtur më 20 qershor 2013 solli vendimin e hapjes së konkursit për bursë studentore për vitin akademik 2013-2014. Të drejtë burse kanë të gjithë ata studentë të cilët përmbushin kërkesat e parashtruara nga Fondi Humanitar "Malësia".

Përparësi në përfitim të bursës kanë studentët e dalluar malësorë të cilët ligjeratat i ndjekin në gjuhën shqipe. Aplikantët këshillohen të lexojnë me vëmendje formularin përkatës për bursë i cili specifikon kushtet e konkurimit.

Aplikantët këshillohen që materialin e tyre aplikues ta postojnë në adresën e Fondit Humanitar "Malësia". Një veprim i tillë përshpejton procesin aplikues të çdo studenti. Gjithashtu ne u bëjmë apel aplikantëve që dokumentacioni i tyre të paraqitet sa më dinjitoz, i printuar, duke respektuar normat aplikuese.

Kërkojmë nga aplikantët që të jenë të vëmendshëm në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar. Vetëm aplikacionet e plota do të merren parasysh. Jeni të këshilluar që dokumentacionin e pa plotësuar ta mbani te veltja juaj deri në momentin kur të jenë i plotë me ç'rast do ta postoni në adresë të Fondit. Çdo aplikim që ka vulen postare pas 1 nëntorit 2013 nuk do të merret parasysh. Për çdo informacion të mëtejshëm mund të kontaktoni zyrën e Fondit Humanitar si edhe sitin tonë të internetit ku mund të pajiseni me formularin aplikues dhe të njoftoheni me kushtet dhe afatet e konkurimit. Ndarja e bursave do të përcaktohet në mbledhjen e radhës të dhjetorit mbasi i gjithë materiali aplikues të ketë mbërritur në zyrën tone:

Fondi Humanitar "Malesia"
210 Riverside Dr. #1C
New York, NY 10025
USA

Fondi Humanitar "Malësia" ju dëshiron sukses në procesin aplikues!

Sinqerisht,

Ëjllo M. Berishaj

Fondi Humanitar "Malësia" si organizatë jofitimprurëse është i klasifikuar në seksionin 501 (c) 3 të Kodit të Brëndshëm Tatimor. Organizata synim kryesor ka ngritjen dhe avancimin kulturor, arsimor, politik dhe ekonomik të shqiptarëve të cilët jetojnë në Mal të Zi, respektivisht në rajonin e Malësisë së Madhe me qendër Tuzin, si dhe diasporën shqiptare në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Çdo kontributet financiar pranë Fondit Humanitar është i deklarueshëm kundrejt rembursimit taksor si për individët dhe korporatat dhe kontributet nga organizatat private trajtohen si distribuime kualifikuese duku iu menjanuar taksës shtesë.